



Projekti është financuar nga
Bashkimi Evropian



Projekti është ko-financuar nga
CARE Deutschland/Luxembourg e.V

PËRFSHIRJA E GRAVE NGA KOMUNITETET JO-SHUMICË NË TREGUN E PUNËS.

Faktet dhe rezultatet e projektit



Projekti po implementohet nga



Ky publikim është përpiluar me mbështetjen e Bashkimit Evropian. Përmbytja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e CARE International dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se reflekton pikëpamjet e Bashkimit Evropian

Botues:
CARE International

Për botuesin:
Sumka Bučan

Autor:
CARE International

Redaktorët:
Dragan Perić
Vesna Jovanović

Dizajn dhe shtypje:
Polyesterday



CARE në Ballkan me kënaqësi prezanton këtë broshurë, e cila prezanton rezultatet kryesore të projektit, por edhe qasjet dhe hapat kryesore që janë përdorur për t'i motivuar, angazhuar dhe përfshirë gratë e bashkësive etnike jo shumicë në tregun e punës në Republikën e Maqedonisë. Në bashkëpunim me organizatën partnere Iniciativa Qytetare e Femrave ANTIKO – një rrjet nga 16 organizata themeluese nga Maqedonia, CARE me sukses implementoi projektin “Përfshirja e grave të bashkësive etnike jo shumicë në tregun e punës”, duke targetuar pesë rajone në Republikën e Maqedonisë – Shkup, Tetovë, Manastir, Shtip dhe Kumanovë.

Ky projekt është pjesë e përpjekjeve më të gjera të CARE që ekonomikisht t'i fuqizojë gratë jo vetëm në rajonin e Ballkanit, por edhe në nivelin botëror. Objektivat dhe aktivitetet e projektit “Përfshirja e grave të bashkësive etnike jo shumicë në tregun e punës” qëndrojnë në thelbin e misionit botëror të CARE për t'i dhënë fund varfërisë, duke vendosur fuqizimin e gruas në qendrën e programit tonë. Me këtë projekt, ne kemi trajtuar çështjen e marginalizimit të pakicave etnike dhe qasjen e grave të cënueshme dhe të përjashtuara, në tregun e punës.

Ekipi i projektit të CARE dhe ANTIKO, së bashku me OJQ-të tona bashkëpunëtorë në zonat qëllimore, i kushtoi vëmendje të posaçme afrimi drejt grupeve të marginalizuara të grave të bashkësive etnike jo shumicë dhe dhënies së informacioneve, trajnimit, mentorimit dhe mbështetjes së nevojitur për të rritur mundësitë e punësimit të secilës shfrytëzuese të projektit. Nga ana tjetër, bashkëpunimi me vepruesit lokal dhe inkuadrimi i tyre në dialogun social i cili ishte inicuar nga projekti, hapi dyert për pranim më të gjerë dhe ngritjen e vetëdijes së bashkësisë në lidhje me çështjen e qasjes në tregun e punës për ato shfrytëzuese të cilat praktikisht asnjëherë më parë nuk kanë qenë kërkuese aktive të punës.

Jemi krenar se rezultatet e projektuara janë arritur mbi pritjet për më se 30%. Është ky produkt i metodologjisë gjithëpërfshirëse, përkushtimit, bashkëpunimit në këtë fushë, së bashku me vepruesit e ndryshëm dhe përpjekja e madhe e bashkëpunëtorëve në terren për t'iu qasur dhe për të targetuar ata që kanë patur nevojë për ndihmë. Shpresojmë se projekti ka patur efekt të madh në jetat e 326 grave të cilat ishin shfrytëzuese të drejtpërdrejta, por edhe në jetat e shumë grave që akoma do të përfitojnë nga përpjekjet e përfaqësimit nga projekti dhe nga replikimi i qasjes e cila është përdorur. Kështu, ne falënderojmë gjithë bashkëpunëtorët, të cilët, duke bashkëpunuar në drejtim të arritjes së rezultateve të projektit, kanë kontribuar në rritjen e përfshirjes së grave të bashkësive etnike jo shumicë në tregun e punës dhe ngritjen e vetëdijes për rëndësinë e fuqizimit ekonomik të gruas.

M-r Sumka Buçan,
Drejtore, CARE International Ballkan

PËR CARE INTERNATIONAL

CARE International është federatë e organizatave joqeveritare ndërkombëtare, e themeluar në vitin 1945, për t'u dërguar pako përkujdesjeje për shpëtim (CARE packages) të mbijetuarve të Luftës së Dytë Botërore. Sot, ne veprojmë në 95 vende të botës, me mision për të luftuar kundër varfërisë, përjashtimit social dhe padrejtësisë, duke patur gratë dhe vajzat në qendrën e aktiviteteve tona. CARE International ka qenë aktive në Ballkan që nga viti 1993, kur aktiviteti i saj parimor, dhe njëkohësisht në vitet menjëherë pas luftës, ishte shpërndarja e ndihmës humanitare dhe ilaçeve në mesin e popullit të goditur nga lufta. Shumë vite pas luftërave në vendet e ish Jugosllavisë, CARE ishte aktive në rikonstruimin e mbështetjes së kthimit, ku ishte përfshirë ndihma në çështjet e banimit, ofrimi i ndihmës amvisërive, mbështetja psikosociale dhe aktivitetet e ndërtimit të paqes.



Gjatë viteve, ashtu si ndryshoheshin nevojat, fokusi i punës së organizatës në Ballkan poashtu u ndryshua, duke bërë që komponentin zhvillimor të mbizotërojnë. Qëllimi jonë në Ballkan është të sigurohet njohja dhe përmbushja e të drejtave sociale, ekonomike dhe politike e grupeve të cënueshme dhe të marginalizuara, duke kontribuar kështu për paqen e qëndrueshme në rajon. Ne promovojmë vlera të barazisë gjinore, tolerancës ndaj dallimeve dhe jo-dhunë. Misioni i CARE në Ballkan përfshin programe në Bosnje e Hercegovinë, Kroaci, Serbi, Kosovë, Mal të Zi, Maqedoni dhe Shqipëri.

CARE vendos barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave (e sidomos fuqizimin ekonomik të grave) në qendrën e të gjitha programeve të saja. Të gjitha projektet dhe iniciativat po orvaten për fuqizimin e grave dhe grupeve pakicë në Ballkan, që ato të inkuadrohen më tepër në shoqëri dhe plotësisht t'i ushtrojnë të drejtat e tyre. Ne po e arrijmë këtë duke u ofruar mbështetje të drejtpërdrejtë shfrytëzuesve, por edhe me mbështetjen e zhvillimit të një shoqërie të fuqishme me rol aktiv në jetën politike dhe sociale. Ne veprojmë në partneritet me organizatat e shoqërisë civile (OJQ) dhe punojmë bashkë me ato në drejtim të përmirësimit të cilësisë së shërbimeve që ato ofrojnë, të zhvillimit të bashkëpunimit më të mirë me autoritetet e tyre dhe arritjen e qëndrueshmërisë së rezultateve tona, si dhe ndikimin afatgjatë.

Çka do të thotë fuqizimi ekonomik i grave?


CARE definon fuqizimin ekonomik të grave si proces me të cilin gratë rrisin të drejtën e tyre për resurse ekonomike dhe fuqinë e tyre për të sjellë vendime me të cilat do të përfitojnë ato vet, familjet e tyre dhe bashkësitë e tyre. Kjo gjë kërkon qasje dhe kontroll të barabartë të resurseve ekonomike, pronave, mundësive, si dhe ndryshime të strukturës sociale dhe ekonomike, me të cilat do të përfitojnë gratë dhe burrat në mënyrë të barabartë.



PËR INICIATIVËN QYTETARE TË FEMRAVE ANTIKO

IQF është një rrjet ndëretnik, i përbërë nga 16 organizata themeluese nga Maqedonia. ANTIKO është themeluar në vitin 1999, si përgjigje ndaj nevojës së shoqërisë për një rrjetëzim multi-etnik dhe aksion ekipi në fushën e demokracisë, pluralizmit dhe tolerancës – promovimi i bashkëpunimit ndëretnik, barazia gjinore dhe pjesëmarrja aktive e qytetarëve në ndërtimin e paqes brenda bashkësisë, përmes prosperitetit ekonomik, social dhe kulturor, si dhe përmes respektimit të të drejtave fundamentale të njeriut për gjithë njerëzit. Rrjeti i ANTIKO me veprime të koordinuara dhe partneritet me organizata tjera të shoqërisë civile, me njësitë e vetëqeverisjes lokale, me sektorin e biznesit, mediat dhe me veprues tjerë, po zbaton aktivitete të vazhdueshme që kanë efekt pozitiv në 3 nivele: në nivelin e individëve, grupeve dhe bashkësive.

PROJEKTI



Përgjigja ndaj gjendjes aktuale në Republikën e Maqedonisë, ku shkallët e aktivitetit të grave janë vazhdimisht nën mesataren e BE (është posaçërisht e dukshme në mesin e grave të bashkësive etnike jo shumicë) dhe dëshira për të kontribuar në realizimin e një tregu përfshirës në Maqedoni, ku të gjithë qytetarët, duke përfshirë edhe ata të kategorive të cënueshme, do të kenë mundësi të barabarta të qasjes, CARE International dhe organizata partnere Iniciativa Qytetare e Grave Antiko, filluan një projekt “Përfshirja e Grave të Bashkësive Etnike Jo Shumicë në Tregun e Punës” në janar të vitit 2016. Qëllimi i këtij projekti ishte rritja e qasjes dhe prania e grave të bashkësive etnike jo shumicë në tregun e punës në pesë rajone të Maqedonisë - Shkup, Tetovë, Manastir, Kumanovë dhe Shtip, përmes fuqizimit të kapaciteteve individuale të grave dhe qasjen në rrethin e tyre të menjëhershëm dhe më të gjerë, për të promovuar rolet e reja të grave si punonjëse, punëtore të trajnuara dhe sipërmarrëse, dhe për ta mbështetur punësimin e tyre.



Projekti "Përfshirja e Grave të Bashkësive Etnike Jo Shumicë në Tregun e Punës" u financua nga Bashkimi Evropian

në një shumë nga 200.000 euro dhe u ko-financua nga CARE Deutschland/Luxembourg e.V (10.520 euro), u menaxhua nëpërmjet të Zyrës së Financimit dhe Kontraktimit pranë Ministrisë së Financave dhe u implementua nga CARE International (CARE Deutschland/Luxembourg e.V) dhe Iniciativa Qytetare e Femrave Antiko. Projekti u realizua brenda 18 muajve.



Projekti "Përfshirja e Grave të Bashkësive Etnike Jo Shumicë në Tregun e Punës" targetoi gra të bashkësive etnike në Shkup, Tetovë, Shtip, Kumanovë dhe Manastir, duke iu qasur atyre dhe familjeve të tyre në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe duke zbatuar një metodologji të posaçme të projektit, si kombinim i ndërtimit të kapaciteteve dhe mentorimit, me qëllim rritja e motivimit dhe kushteve për përfshirjen e tyre aktive në tregun e punës. Projekti ofroi mbështetje, në kuptimin e ngritjes së njohurive për kërkim aktiv të punës dhe fitimit të shkathtësive të reja për punësim për 326 gra të bashkësive etnike jo shumicë – Shqiptare, Rome, Turke, Serbe dhe të tjera, për t'u bërë më të konkurrueshme në tregun e punës. Gjatë kontaktit me autoritetet në të gjitha nivelet dhe institucionet përgjegjëse për të punuar me grupet e marginalizuara, projekti fuqishëm promovonte konceptin e krijimit të mundësive të barabarta për të gjithë në kuptimin e qasjes në tregun e punës, si një nga parakushtet më të rëndësishme për arritjen e përmirësimit të qëndrueshëm social. Kjo gjë u arrit nëpërmjet të:

- Programi për Ndërtimin e Kapaciteteve në formë të punëtorive për gjithsej 326 gra nga komunitetet lokale të zonave qëllimore, me të cilin është përfshirë përqindja më e lartë e bashkësive etnike jo shumicë, u zhvillua me qëllim rritja e mundësive të punësimit të grave në temat në vijim:
 - ▶ Barazia gjinore, konceptet gjinore në tregun e punës, motivimi individual për punësim;
 - ▶ Shkathtësitë e përgjithshme jetësore: komunikimi dhe shkathtësitë e buta (soft skills);
 - ▶ Këshillimi në lidhje me punën, përputhja me vendin e punës dhe këshillat udhëzuese në karrierë;
 - ▶ Informacionet bazë mbi zhvillimin e biznesit dhe vetëpunësimin;

- Puna individuale me 153 gra të përfshira me projektin për ndërtimin e kapaciteteve të projektit për rritjen e motivimit për punësim.
- Këshillimi për punë dhe karrierë për 145 gra të përfshira në ndërtimin e kapaciteteve të projektit.
- Trajnimet profesionale për 172 gra, për shkathtësi siç janë qepja, aftësitë kompjuterike, gjuhët, kurset e bukurisë, etj. në komunikim me vepruesit lokal në tregun e punës.
- Ofrimi i praktikës profesionale për 30 gra (6 për rajon qëllimor) në kompanitë lokale.
- Aktivitetet në terren dhe mbështetja psikosociale që merren me norma dhe qëndrime tradicionale me më se 150 familje.

Projekti organizoi 15 sesione për dialog social në bashkësitë lokale të të gjitha rajoneve qëllimore, me më se 150 pjesëmarrës, midis grupeve qëllimore dhe përfaqësuesve të tyre (OJQ lokale) dhe veprues tjerë – përfaqësues të autoriteteve, institucioneve dhe bizneseve. Njëra nga çështjet që u prioritetizua me diskutimet ishte mungesa e informacioneve rreth mundësive të punësimit dhe edukimit, të ofruara nga Agjencia e Punësimeve. Në këtë mënyrë, Projekti inkuadroi stafin e Agjencisë së Punësimit në aktivitetet e veta, për t'i prezantuar sa është e mundur më tepër informacione lidhur me ekzistimin e masave aktive nga Agjencia e Punësimit.



<http://sheisbuildingfuture.org/en/about-the-project/>

Ardiana Ramadani, Kumanovë

"Ngurroja për t'u bërë pjesë e trajnimeve të ofruara gjatë projektit, sepse nuk besoja se ata do më ndihmonin fare. Në fund, vendosa që t'u jap mundësi atyre, dhe njohuria e grumbulluar më ndihmoi që vetë ta përgatisja një biografi të shkurtër (CV) dhe një letër motivimi. I përdora ato për të aplikuar praktikën profesionale tek Agjencia e Punësimit në Kumanovë dhe e fitova! Tani po ndjek praktikë profesionale në Bankën Tutunskia dhe kam gjasa për të fituar një punë të përhershme në bank pas përfundimit të praktikës. Njëkohësisht, unë po ndjek një kurs për gjuhë gjermane, të ofruar nga projekti. Komibinimi i praktikës profesionale dhe kursin e gjuhës gjermane do të më ndihmojnë t'i avancoj kapacitetet dhe aftësitë e mia dhe si rezultat, gjasat e mia për punësim".



GJENDJA NË LIDHJE ME PËRFSHIRJEN EKONOMIKE TË GRAVE TË BASHKËSIVE ETNIKE JO SHUMICË NË MAQEDONI

Shkallët e aktivitetit të grave në Republikën e Maqedonisë janë vazhdimisht nën mesatarën e BE. Papunësia e lartë tek gratë në Maqedoni është posaçërisht e dukshme tek gratë e bashkësive etnike jo shumicë. Vlerat tradicionale, me reduktimin e grave drejt roleve të tyre tradicionale të amviseve dhe nënave me të cilat po pengohen ato nga të menduarit për një vend pune ose karrierë janë ende gjerësisht të përhapura në komunitetet lokale, sidomos tek pakicat e ndryshme etnike. Në vitin 2015, shkalla e aktivitetit të grave në Maqedoni ishte 44.9%, kundrejt 64.3% në BE (Burimi: EUROSTAT). Sipas Raportit të Forumit Ekonomik Botëror të vitit 2016, Maqedonia rangohet në vendin 103 në botë, me një boshllëk gjinor nga 0.66 në pjesëmarrjen në tregun e punës.

	Rajoni i Shkupit	Rajoni Lindor	Rajoni i Pellagonisë	Rajoni i Pollogut	Rajoni Verilindor
2011	56.1	58.2	63.9	43.9	53.7
2012	55.3	61.5	62.8	44.5	52.1
2013	55.3	61.0	64.4	46.6	54.2
2014	56.3	63.6	65.3	46.1	54.2
2015	54.4	62.5	66.3	47.1	54.0

Tabela 1. Shkallët e aktivitetit sipas rajoneve në vitin 2015

WKur bëhet fjalë për punësimin, gjendja është edhe më e vështirë: në përgjithësi, ka diskrepancë të madhe në shkallën e punësimit midis burrave dhe grave, sidomos në zonat rurale (ku ka shumë bashkësi etnike). Burrat janë më shumë të punësuar me orar të plotë – 60.8% (gratë 39.2%). Në lidhje me llojin e punësimit, gratë në Republikën e Maqedonisë tradicionalisht janë kryesisht të përfaqësuara si punonjëse dhe punëtore të papaguara në familje: gratë përfaqësojnë 42.5% të punonjësve, 61.7% të punëtorëve të papaguar në familje, përderisa vetëm 24.8% janë punëdhënëse dhe 18.4% janë të vetëpunësuar.

Shkallët e papunësisë së grave ndryshojnë nga rajoni në rajon dhe të popullatës rurale dhe urbane janë prezantuar në Tabelën 2: Shkallët e papunësisë në rajonet qëllimore (gratë) në vitin 2015.

	Rajoni i Shkupit	Rajoni Lindor	Rajoni i Pellagonisë	Rajoni i Pollogut	Rajoni Veri-Lindor
Burra	28.1	20.7	21.7	27.6	41.7
Gra	22.1	20.5	21.2	35.6	45.7
Zonat urbane					
Burra	24.5	25.1	28.7	31.9	39.9
Gra	20.5	14.8	27.8	34.1	47.7
Zonat rurale					
Burra	35.3	14.7	12.2	25.7	44.5
Gra	27.6	11.2	8.8	36.7	41.1

Tabela 2. Shkallët e papunësisë në rajonet qëllimore sipas gjinisë në vitin 2015



Institucionet qeveritare investojnë përpjekje për të arritur një shoqëri të mundësive të barabarta për të gjithë qytetarët ku gratë, pakicat etnike, të varfërit, njerëzit me aftësi të kufizuara dhe njerëzit tjerë të cenueshëm do të shfrytëzojnë mundësi të barabarta, në mesin e të cilave dhe mundësitë e punësimit. Megjithatë, për shkak të mungesës së afrimit drejt qytetarëve të privuar, programet zyrtare për integrim nuk marrin aq shumë në konsideratë kushtet e jetesës

brenda bashkësive etnike dhe deri më tani kanë ndërmarrë veprime shumë të kufizuara në përmirësimin e qasjes së pakicave etnike në tregun e punës. Kështu, përmirësimi i njohurive të profesionistëve të inkuadruar në këtë çështje është vendimtar për programe më efektive qeveritare, që targetojnë kategoritë e cenueshme.

Rafeta Kriezi, Shkup, studente e Fakultetit të Shkencave Mjekësore



"I tërë projekti i implementuar nga CARE dhe ANTIKO, me të gjitha aktivitetet e veta, më ndihmoi në masë të madhe që, para së gjithash, nëpërmjet të praktikës profesionale të organizuar nga projekti. Marrja pjesë e praktikës profesionale më ndihmoi në ngritjen e njohurive të mia praktike, që është si shtesë e teorisë të cilën kam mësuar si studente e shkencave mjekësore. Veç kësaj, kam patur mundësinë që të njihja shumë vajza tjera Rome, të cilat kanë marrë pjesë në aktivitetet e organizuara nga projekti. Mësova për konceptet e barazisë gjinore, kërkimin aktiv të punës dhe trajnimet e planifikimit të biznesit".

Gratë nga grupet etnike jo shumicë po përballen me segregim të shumëfishtë kur bëhet fjalë për çështjen e punësimit. Përveç ngurrimit të zakonshëm të punëdhënësve (nga të cilët 75% janë burra, siç tregojnë statistika) për të inkuadruar gratë, me paragjykimin se ato do të jenë më pak të arsimuara dhe profesionale, kërkojnë më tepër mungesa nga puna, etj. Gratë nga bashkësitë etnike jo shumicë tradicionalisht janë



më të orientuara drejt marrjes së roleve të amviseve, grave dhe nënave. Kjo tendencë afatgjate çoi drejt joaktivitetit praktik të grave të bashkësive etnike jo shumicë kur bie fjala për hyrjen në tregun e punës, mungesës së shkathtësive sipërmarrëse dhe motivimit. Bashkësitë e tyre të menjëhershme inkurajojnë qëndrimet konservative, ndërsa institucionet qeveritare kanë mungesë të kapacitetit dhe programeve për ta trajtuar këtë problem.

Gratë e bashkësive etnike jo shumicë në përgjithësi janë të interesuara për hyrje në tregun e punës. Ajo që u mungon atyre është vetëbesimi!



REZULTATET E PROJEKTIT

Projekti filloi me trajtimin e problemit në mënyrë holistike: ai futi në përdorim alternativa për llojet tradicionale të roleve, implementoi metoda konkrete për t'i përmirësuar shkathtësitë e grave dhe statusin e arsimit, bëri lobimin për të drejtat e tyre fundamentale, duke përfshirë këtu të drejtën e punësimit. Ai punoi me rrethin e menjëhershëm të grave qëllimore të bashkësive etnike jo shumicë, në kuadër të përpjekjes për të ndryshuar normat sociale të cilat pengojnë gratë nga hyrja në tregun e punës. Projekti u lidh me institucione që punojnë me punësimin, duke prezantuar metodën e punës me popullsinë e cënueshme, për ta integruar këtë çështje në punën e tyre afatgjate, dhe për ta hequr.

Pas pothuajse 18 muajve të punës intensive me gratë dhe homologët e tij, projekti ia doli me arritjen e disa rezultateve të cilat janë prezantuar si vijon:

Projekti në numra:

326 gra morën pjesë në programin e trajnimit lidhur me: konceptet gjinore në tregun e punës; komunikimin dhe shkathhtësitë e buta (soft skills); këshillimin për punësim, përputhjen me vendin e punës dhe këshillat udhëzuese në karrierë; informacionet bazë mbi zhvillimin e biznesit dhe vetëpunësimin;

61 ditë trajnimi për 1.479 gra;

30 gra finalizuan praktikë profesionale në kompani lokale;

172 gra me sukses kryen kurse teknike;

15 sesione të dialogut social në bashkësitë lokale të të gjithë rajoneve qëllimore, me më se 150 pjesëmarrës, midis grupeve qëllimore dhe përfaqësuesve të institucioneve/organizatave qeveritare dhe joqeveritare;

Rreth 180 shfrytëzuese të projektit ishin lëndë e vizitave nga dera në derë me më se 500 anëtarë të familjeve të grave të bashkësive etnike jo shumicë, të cilat u kontaktuan nga ekipi i projektit.

Projekti u kushtoi vëmendje të posaçme nevojave të pjesëmarrësve në trajnim. Paralelisht me programin e trajnimit për gra, projekti organizoi punëtori interaktive për fëmijët e tyre, për ta bërë këtë program trajnimi të qasshëm madje edhe për ato gra të cilat nuk do të kishin mund të kishin përkujdesje alternative për fëmijët e tyre. Kështu, do të ketë punëtori me fëmijë, me të cilat nënat do të mund, në mënyrë të relaksuar, të marrin pjesë aktive në trajnime.

Numri i përgjithshëm i fëmijëve të sistemuar në këto punëtori kreative arrinte 360, në moshë midis 5-10 vjeç. Nëpërmjet të punëtorive kreative (gjithsej 44 për të gjitha rajonet qëllimore), fëmijët ishin të inkurajuar që të eksploronin potencialin e tyre kreativ, si dhe janë zhvilluar aftësitë e tyre motorike nëpërmjet të punës individuale dhe në grup.



Projekti përfshiu 131 gra Rome, 125 Shqiptare, 20 Turke, 3 Boshnjake, 4 Serbe, 1 Çeke dhe 42 gra Maqedone. Nga gjithsej 326 gra të përfshira, 26% kanë qenë nga rajoni i Tetovës, 20% nga rajoni i Shtipit, 19% nga rajoni i Manastirit, 18% nga rajoni i Kumanovës dhe 17% nga rajoni i Shkupit.


Projekti u siguria se pjesëmarrëset në programin e trajnimit kanë qenë të:



Projekti u siguria se pjesëmarrëset në programin e trajnimit kanë qenë të paktën me arsim fillor (40%), me arsim të mesëm (39%), studente (3%), me arsim më të lartë (9%) dhe arsim të lartë (9%). Madje edhe nëse struktura arsimore e grupeve ka qenë e shumëllojshme, programi i trajnimit duhej të disenjohej në mënyrë që të jetë i kuptueshëm për secilën, njëkohësisht duke qenë interesante për pjesëmarrëset.

Interesi më i madh për ndërtimin e kapaciteteve të projektit ishte në mesin e grave të moshës nga 16-27 vjeçe, të cilat rregullisht merrnin pjesë në programet e trajnimit – 49% të pjesëmarrëseve ishin në këtë grupmoshë. 37% kanë qenë të moshës nga 28-38 vjeçe dhe 14% të moshës nga 39-49 vjeçe.

Arritjet konkrete të projektit lidhur me përfshirjen e grave të bashkësive etnike në tregun e punës:



METODA JONË


Hapi 1:

Kontakti i drejtpërdrejtë me shfrytëzueset

Ekipi i projektit vendosi se suksesi do të ishte arritur vetëm nëse do të siguroheshte prania e përhershme në bashkësitë, me komunikim të vazhdueshëm me shfrytëzueset potenciale – gratë e bashkësive etnike jo shumicë – dhe vepruesit lokal që trajtojnë çështjet e punësimit. Çështja e grave që ende po mbajnë rolet tradicionale të amvisëve dhe nënave, gjë kjo e cila i pengon ato nga të menduarit për punë ose karriere mund të kapërcehet me ndihmën e mbështetjes nga ekipi i projektit, të cilin ata e njohin dhe i besojnë.



Tipet profesionale dhe llojet e tjera të trajnimit



Duke patur parasysh këtë, projekti u lidh me OJQ përfaqësuese dhe të etabluara lokale nga secili rajon qëllimor: IRIZ – Shkup, Florence Nightingale – Kumanovë, Happy Life – Tetovo, KLEA – Manastir dhe Shoqata e Shoqërisë Ndëretnike për të Drejtat e Njeriut – Shtip, me njohuri dhe përvojë në punën me gra të cënueshme dhe me reputacion të mirë në bashkësitë etnike

jo shumicë. Projekti ka investuar në ndërtimin e kapaciteteve të stafit të OJQ-ve – mediatorët lokal, duke i mundësuar ata që të kryejnë punë shumë më cilësore në bashkësitë, si dhe kanë organizuar ndërtimin e kapaciteteve në temat në vijim: çështjet e barazisë gjinore, rëndësia e mundësive të barabarta ekonomike si për gratë ashtu dhe për burrat; luftimi i normave tradicionale lidhur me pozitën e grave në shoqëri; metodologjitë e punës në bashkësitë lokale; inkurajimi i dialogut social; teknikat e lehtësimit dhe bazat e punës psikosociale me tërë familjet tradicionale. Veç trajnimeve, ndihmësit e projektit ishin të përfshirë në planifikimin e aktiviteteve të projektit, duke ndarë praktika të mira brenda ekipit dhe bashkëpunim të ndërsjellë. Kështu, projekti krijoi kapacitet lokal, duke pajisur OJQ shoqëruese (nëpërmjet të mediatorëve të tyre lokal) me njohuri mbi mbështetjen e grave dhe familjeve të tyre, për të kuptuar çështjet lidhur me punësimin, dhe të aftë për të motivuar dhe mobilizuar gratë që të bëhen më aktive në gjetjen e punësimit, duke rritur kështu mundësitë e mirëqenies së familjarëve të tyre më të afërt.

Hapi 2:

Identifikimi i nevojave të përfituesve

Institucionet dhe/ose organizatat e ndryshme shpeshherë e zbatojnë qasjen nga lartë poshtë, e cila merret me çështjet zhvillimore, por nuk i marrin parasysh domosdoshmërisht nevojat reale të popullsisë qëllimore. Mirëpo, projekti realizoi një studim bazë për të identifikuar nevojat dhe potencialet reale të shfrytëzuesve të punësimit, si dhe i përshtaten ato me kërkesën e tregut të punës. Studimi përfshiu intervista personale me më shumë se 200 gra dhe siguroi informacione të mjaftueshme për ekipin e projektit me qëllim hapja e shtegjeve të ardhshme

drejt punës dhe për të ngritur kapacitetet e projektit në bazë të kërkesave dhe nevojave përfundimtare të përfituesve. Për më tepër, CARE dhe ANTIKO, në bashkëpunim me 5 OJQ bashkëpunëtoresh, filloi një proces të hapur të aplikimit për pjesëmarrje në trajnimet e projektit, për të identifikuar nevojat dhe dëshirat më konkrete të popullsisë qelimore për zhvillimin e tyre personal të mëtejshëm. Si vazhdim, në bazë të këtij procesi të aplikimit, ekipi i projektit përzgjedhi 326 gra për të realizuar aktivitetet për ngritjen e kapaciteteve.

Hapi 3:

Zhvillimi i planit të trajnimit dhe zbatimi i tij



Në bazë të një studimi të hollësishëm fillestar, të dhënat nga pyetësorët e procesuara në bashkësitë lokale nga mediatorët lokal dhe në kuadër të procesit të aplikimit, ekipi i projektit disenjoi një program për ndërtimin e kapaciteteve për t'i përputhur kërkesat dhe dëshirat e konsumatorëve përfundimtarë të projektit, por edhe për kërkesat e tregut të punës. Kështu, pjesëmarrëset (326 gra të bashkësive etnike jo shumicë në kërkimin e punësimit nga komunat e Shkupit, Manastirit, Tetovës dhe Kumanovës) pranuan trajnim në:

- Ngritjen e vetëdijes së përgjithshme lidhur me barazinë gjinore, konceptet gjinore në tregun e punës, motivimin individual për punësim;
- "Shkathtësitë e buta" dhe teknikat e komunikimit, të dobishme për procesin e kërkimit aktiv të punës dhe punësimit të tyre;
- Këshillimin e punës së profiluar, udhëzimet për karrierë dhe përputhja me vendin e punës (në bashkëpunim me bizneset lokale dhe institucionet lokale, parimisht me Agjencinë e Punësimit);
- Informacionet elementare mbi zhvillimin e biznesit dhe vetëpunësimin.

Si rezultat i kësaj, projekti motivoi **75 gra** për ta ndryshuar statusin e tyre nga kërkuese pasive në kërkuese aktive të punës, të cilat, në kombinim me njohuritë e tyre teorike dhe praktike që kanë grumbulluar, do t'i rrisin gjasat e tyre për punë të sigurt në të ardhmen.

Gjatë zbatimit të projektit dhe komunikimit intensiv me shfrytëzueset e projektit në kuadër të trajnimeve dhe punës individuale me familjet, u bë e dukshme se shumica e grave janë të interesuara për inkuadrim në trajnim praktik nëpërmjet të trajnimeve teknike siç janë qepja, aftësitë kompjuterike, kurset e bukurisë, etj., gjë kjo e cila shkaktoi riformësimin e aktiviteteve për ndërtimin e kapaciteteve të projektit. Kështu, edhe pse nuk është planifikuar në fillim, 172 gra janë përfshirë në këto kurse teknike.

Hapi 4:

Vizitat e rregullta familjeve/mbështetja psikosociale

Gratë e bashkësive etnike jo shumicë tradicionale po përballen me vështirësi në përpjekjen përfundimtare për të hyrë në tregun e punës për arsye të mungesës së kapaciteteve individuale, mungesës së mundësive të punësimit, por gjithashtu për arsye të qëndrimit të pafavorshëm të rretheve të tyre të menjëhershme për të kapërcyer normat tradicionale në lidhje me pozitën e grave në shoqëri: atyre të nënave dhe të amviseve. Kjo rrethanë ka ndikime negative mbi motivimin e grave për të kërkuar punë ose për ta parë vetën si anëtare të barabarta të shoqërisë me burrat.

Në të shumtën e rasteve, gratë e bashkësive etnike jo shumicë, të cilat morën pjesë në projekt nuk kanë qenë të vetëdijshme për ekzistimin e mundësive të ndryshme ose për zhvillimin plotësues profesional (siç janë ato të ofruara nga Agjencia e Punësimit, nga OJQ të ndryshme, institucione tjera qeveritare) ose të masave aktive të punësimeve, siç është praktika profesionale, grantet për vetëpunësim dhe ngjashëm. Gjatë vizitave intensive të bëra familjeve, ekipet e projektit ua kanë prezantuar këto informacione shfrytëzuese potenciale, duke diskutuar në përgjithësi rëndësinë e të qenit e punësuar dhe me pjesëmarrje të barabartë në tregun e punës. Kjo qasje individuale rezultoi me atë se gratë u bënë më aktive, të hapura dhe të motivuara për të marrë pjesë në trajnime, por gjithashtu edhe për të ndjekur punësimin në mënyrë aktive (29 gra të punësuar, 75 kanë ndryshuar statusin e tyre nga pasive në aktive, 4 kanë aplikuar për masa aktive në Agjencinë e Punësimit dhe 3 kanë aplikuar për grant për vetëpunësim si rezultat i drejtpërdrejtë i aktiviteteve të projektit).

Hapi 5:

Dialogu social dhe diskutimet në tryeza të rrumbullakëta

Një nga aktivitetet më të rëndësishme të zbatuara nga projekti, e i cili kishte efekt të madh mbi qëndrimet e vepruesve lokal lidhur me punësimin e grave ishte organizimi i dialogut social të lehtësuar nga projekti midis grave të bashkësive etnike jo shumicë dhe organizatave të tyre përfaqësuese dhe vepruesit lokal,



përgjegjëse për punësimin e tyre, lidhur me çështjen e përfshirjes së grave nga bashkësitë etnike jo shumicë në tregun maqedonas të punës.

Projekti organizoi 15 sesione të dialogut social në bashkësitë lokale nga të gjitha rajonet qëllimore, me më se 150 pjesëmarrës nga institucione/organizata qeveritare, duke ofruar kështu platformë për diskutime, ku përfaqësuesit e të gjithë vepruesve të përfshirë në çështjen e punësimit, kishin mundësi për të shkëmbyer informacione, përvoja dhe qëndrime lidhur me problemin e sfidave ekzistuese, dhe aty numërohen, shqyrtohen dhe prioritetizohen pengesat për punësimin e grave të bashkësive etnike jo shumicë. Dialogu social paraqiste një metodë efikase për të ndikuar ndryshimin e qasjes tek vepruesit (institucionet, autoritetet, por edhe bizneset), ku gratë kanë patur mundësi të rralla për shkëmbim të informacioneve me shfrytëzueset përfundimtare.

Problemet e identifikuara gjatë sesioneve të dialogut social:

- Deri në një shkallë të caktuar, normat sociale pengojnë grate nga punësimi;
- Mosbesimi i përgjithshëm në institucionet;
- Punësimi më së shumti ofrohet në bazë të pjesëmarrjes politike;
- Kushtet e vështira të punës në fabrikat në rajonet qëllimore;
- Mungesa e afrimit të institucioneve drejt shfrytëzuesve përfundimtare të projektit;
- Metoda e arritjes deri tek shfrytëzueset është vjetëruar dhe nevojitet të ndryshohet;
- Gratë nuk janë të vetëdijshme për mbështetjen që ofron Agjencia e Punësimit dhe institucionet tjera.



CARE International Balkans

Zyrat qendrore:

Sarajevo, Bosnia dhe Hercegovina,
Hasana Kaimije 11,
tel. +387 (0)33 536 790

Zyrë ne Serbia:

Belgrade, Petra Lekovica 59,
tel. +381 (0)11 3558 802

Zyrë ne Kosovë:

Pristina, Gazmend Zajmi 21,
tel. +381 (0)38 222 435



Iniciativa Qytetare e Femrave ANTIKO

Rruga Vukovarska 23/1-2, Shkup

tel: +389 2 2614 641

e-posta: contact@antiko.org.mk
antiko@t.mk

ueb faqja: www.antiko.org.mk